

L I G J
Nr.8505, datë 7.7.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8445, DATË 21.1.1999 “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR””

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 2 i ligjit nr.8445, datë 21.1.1999 “Për një ndryshim në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”” ndryshohet si vijon:
“Ngarkohet Ministria e Financave për prodhimin e “Faturës tatimore”, sipas këtij ligji.”

Neni 2

Përdorimi i faturave tatimore fillon më 1 tetor 1999.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2415, datë 19.7.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**